



Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE I OSK-SË në mbështetje të nenit 1 dhe nenit 8, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.2 dhe 1.13 të rregullorës për zgjedhjen e organeve të Odës së Stomatologëve të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 13/03/2023, nxjerrë këtë:

RREGULLAT E MIRËSJELLJES GJATË PROCESIT PËR ZGJEDHJEN E ORGANEVE TË OSK-SË

Neni 1

Qëllimi i Rregullave të sjelljes

Rregullat e sjelljes kanë për qëllim krijimin e kushteve ku anëtarët e OSK-së mund të zgjedhin përfaqësuesit e tyre përmes zgjedhjeve të lira të drejta dhe të mirë informuara, në një atmosferë kolegjiale dhe respekti të rregullave të legjislacionit përkatës.

Neni 2

Përgjegjësitë e kandidatëve dhe mbështetësve të tyre

2.1 Këto Rregulla obligojnë të gjithë anëtarët e OSK-së, veçanarisht kandidatët për anëtarë të organeve të OSK-së.

2.2 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka autoritet ligjor të marrë vendim në pretendimet se janë shkelur dispozitat e këtyre Rregullave.

2.3 Kandidatët për anëtarë të organeve të OSK-së ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të parandaluar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre nga shkelja e këtyre Rregullave.

2.4 Kandidatët për anëtarë të organeve si edhe vetë anëtari i OSK mbajnë përgjegjësi për shkeljet e këtyre Rregullave.

Neni 3

Veprimet e ndaluara

3.1 Gjatë periudhës së fushatës së anëtarëve të OSK-së, kandidatëve për organet e OSK-së i'u ndalohen veprimet si në vijim:

- (a) Keqinformimi, shpifja dhe njollosja e procesit zgjedhor apo kundërkandidatëve në procesin zgjedhor;
- (b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave;
- (c) pengimi ose tentimi për pengimin e zyrtarëve të KQZ-së për përmbushjen e detyrave të procesit zgjedhor;
- (d) premtimi i ndonjë shpërblimi financiar apo ndonjë favor me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve;
- (e) kërcënimi ose tentimi për të kërcënuar anëtarët - kandidatët tjerë për organe të OSK-së apo mbështetësit e tyre;
- (f) nxitja e cilitdo person për të votuar në zgjedhje, i cili nuk ka të drejtë vote;
- (g) nxitja e personit për të votuar më shumë se një herë ose të votojë në emër të një personi tjetër;
- (h) abuzimi me të drejtën e ankesës, ose duke bërë ankesa ose paraqitje të rrejshme, të pavlera dhe irituese në organet përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor;
- (i) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit/provokon, ose që mund të nxisë/provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikimit të tillë;
- (j) për qëllime të promovimit të kandidaturës së tij për anëtarë të organeve të OSK-së duke përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali i cili i referohet personit i cili mban detyrë zyrtare brenda institucionit apo në çfardo forme mund të jetë person me ndikim të anëtarët, ndikim i cili vie nga pozita e tij në institucion:

Neni 4

Veprimet e ndaluara nga shërbyesit publik

- 4.1 Anëtari i OSK-së ose kandidati për anëtarë të organeve të OSK që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i emëruar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë kandidati për anëtarë të organeve të OSK-së në zgjedhje.
- 4.2 Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë anëtarë i OSK-së apo kandidatë për anëtarë të organeve të OSK-së, nuk inkurajonë ose përfiton nga shërbyesi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për kandidatin e caktuar për anëtarë të orgave të OSK-së.

Neni 5

Veprimet e ndaluara gjatë heshtjes zgjedhore

- 5.1 Gjatë periudhës njëzet e katër orëshe (24) para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës e deri në mbylljen e tyre, anëtarët e OSK-së, kandidatët për anëtarë të organeve të OSK dhe mbështetësit e tyre u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:
- 5.1.1 Ndikimi, shpërndarja ose shfaqja në mënyre tjetër në qendrën e votimit, ose 100 metra brenda Qendrës së Votimit e çfardo lloj materiali me qëllim të ndikimit të votuesve; ose të sigurojë mbështetjen nga personat që presin për të votuar në vendvotime;
- 5.1.2 Bërja e fushatës në çfardo mënyre.

Neni 6

Pranimi i rezultateve të zgjedhjeve

Të gjithë kandidatët për anëtarë të organeve të OSK-së dhe mbështetësit e tyre, obligohet t'u përmbahen rezultateve të zgjedhjeve si dhe të mbështesin zbatimin e plotë të rezultateve zgjedhore të certifikuara.

Neni 7

Sanksionet për shkeljen e dispozitave të kësaj Rregullore

- 7.1 Shkeljet e ndonjërit nga nenet e kësaj Rregullore, në rastet kur këto shkelje nuk kanë ndikuar

në rezultat të zgjedhjeve, konsiderohet si shkelje e lehtë dhe është e sanksionuar me njërin nga masat e mëposhtme :

- (a) Vërejtje
- (b) qortim publik

7.2 Shkeljet e ndonjërit nga nenet e këtyre rregullave, në rastet kur këto shkelje kanë ndikuar në rezultat të zgjedhjeve, konsiderohet si shkelje e rëndë dhe është e sanksionuar me njërin nga masat e mëposhtme :

- (a) Dënimi me gjobë 1000 -3000 euro
- (b) Tërheqje e përkohëshme apo e përhershme nga regjistri i anëtarësisë dhe licencave

7.3 Shqiptimi i masave disiplinore nuk e konsumon veprën penale që realizohet me shkeljen e dispozitave zgjedhore të përcaktuara nga OSK.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore e mirësjelljes hyn në fuqi menjëherë.

Prishtinë me 13.03.2023

Kryetari i KQZ-së

Prof.Asoc.Dr. Fatmir Dragidella

Oska e Stomatologëve të Kosovës
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
OSK - KQZ